



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 976/4 Prot.

Tiranë, më 17/07 / 2018

Lënda: Dërgohen mendime për projekt-vendimin “Për llojet, mënyrën e shkëmbimit dhe e përpunimit të informacionit e të dhënave statistikore, të kërkuara nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, pranë strukturave shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor”.

Drejtuar: ZNJ. OGERTA MANASTIRLIU
MINISTËR
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

TIRANË

E nderuar zonja Ministre,

Referuar shkresës Tuaj nr. 4252 Prot., datë 06.07.2018 me lëndë: “ *Dërgohet për mendim një projektvendim i Këshillit të Ministrave*”, Komisioneri pasi u njoh me përmbajtjen e projekt-vendimit po ju paraqet disa sugjerime si më poshtë:

1. Në shtojcën 1 – Lista e Treguesve, në ata tregues ku është e shënuar edhe ndarja sipas etnisë, rekomandojmë që të zëvendësohet me **“përkatësisë në një pakicë kombëtare”**, ose të konsultohet nëse përdorimi i termit “etni” është në harmoni me ligji Nr. 96/2017 “*Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë*”.
2. Mendojmë se ndarja sipas “etnisë” ose sipas “përkatësisë në një pakicë kombëtare” mund të përfshihet edhe në tregues të tjerë, pasi në këtë mënyrë do të gjeneroheshin të dhëna me rëndësi, qoftë për të adresuar nga ana e shtetit problematikat që ndeshin fëmijët romë apo egjiptianët si kategori vulnerabël, por edhe do t’i vinin në ndihmë KMD dhe gjykatës gjatë shqyrtimit të ankesave apo padive për diskriminim veçanërisht në rastet e diskriminimit të tërthortë. Mund të përmendim treguesin 1, 2, 3, 4, treguesit

në lidhje me vdekshmërinë foshnjore 11, 12 14, 21, 31, 35,36, 36, 38, 43, 44, 45, 46, 47, 50, 52,54,55.

3. E njëjta gjë mund të bëhet edhe me nxjerrjen e të dhënave për fëmijët me aftësi të kufizuar. Mund të përmendim treguesin 1, 4, 5, 7, 36, 37, 38, 43, 45, 46, 50,53, 54, 55.
4. Treguesi 48 ka të bëjë me të dhëna që duhet të raportohen nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Këtu mendojmë se duhet të shtohet si tregues edhe fusha ku pretendohet diskriminim (punësim, arsim, të mira dhe shërbime).
5. Ndarja e treguesve sipas gjinisë ka gjetur pasqyrim më të mirë dhe të gjerë, pasi ndarja sipas gjinisë bëhet pothuajse për shumicën e treguesve.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

ROBERT GAJDA

KOMISIONERI

